



3368 13.06.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERJISË
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

VENDIM

Nr. 2762₇₈ / Datë 06.06 2018

“MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE KESH SH.A”

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”, Asambleja e Përgjithshme pasi shqyrtoi Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 23.01.2018, “Për miratimin në parim të rregullave dhe procedurave standarde të tregtimit të energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a” dhe relacionit Nr. 277/5, datë 01.02.2018 dërguar me shkresë Nr.277/7, datë 15.03.2018 .

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së tregtimit të energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a .
 2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë KESH sh.a, për ndjekjen e të gjitha procedurave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI

Damian Gjoknuri

PËRMBAJTJA

OBJEKTI DHE QËLLIMI	3
PËRCAKTIME	3
PARIMET E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	4
REGJISTRIMI I PJESMARRËSVE NË PROCEDURËN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	5
LISTA E VLERËSIMIT TË PARTNERITETIT	5
TREGTIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	6
VLERËSIMI I OFERTAVE	6
KËRKESA/FTESA PËR OFERTË	7
ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË TREGTIMIT	7
ANULIMI I PROCEDURËS SË TREGTIMIT	8
SQARIMI DHE KORRIGJIMI I OFERTAVE	8
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS	8
DEKLARATA E KONFLIKTIT TE INTERESAVE	8
PROCEDURA E ANKIMIT	9
MONITORIMI I PROCEDURAVE TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	9
SANKSIONE	9
MIRATIMI DHE NDRYSHIMI	9
DISPOZITA KALIMTARE	9
HYRJA NE FUQI	10

**Neni 1
Baza Ligjore**

Këto rregulla hartohen në zbatim të pikës 4/1, të nenit 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar.

**Neni 2
Objekti dhe Qëllimi**

- 2.1** Objekti i kësaj rregullore është të përcaktojë rregulla dhe procedura standarde të tregtimit të energjisë elektrike nga KESH.
- 2.2** Qëllimi i kësaj rregullore është:
- të zhvillojë procedura të thjeshtëzuara, eficiente dhe praktike të tregtimit të energjisë elektrike;
 - të nxisë pjesëmarrjen e subjekteve të licencuara në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike;
 - të nxisë konkurrencën në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike;
 - të garantojë transparencë, barazi, besueshmëri, konfidencialitet dhe mjedis konkurrues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike.

**Neni 3
Përcaktime**

Në këtë rregullore termat e përdorur me poshtë do të kenë kuptimin:

- 3.1 KESH:** do të thotë shoqëria Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
- 3.2 Autoriteti Kontraktues (AK):** do të thotë KESH sh.a. si subjekt i licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.
- 3.3 Subjekt i licencuar:** do të thotë pala tjetër (counterparty) në një marrëdhënie tregtare me KESH, i licencuar për tregtimin e energjisë elektrike dhe që ushtron aktivitetin e saj brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 3.4 Titullari i Autoritetit Kontraktues** do të thotë Administratori i KESH ose personi i autorizuar prej tij në mënyrë të dokumentuar.
- 3.5 Njësia e Administrimit të Prodhimit (NJAP):** do të thotë njësia e parashikuar në strukturën organizative të shoqërisë si përgjegjëse, ndër të tjera, për operimin/shfrytëzimin e njësive gjeneruese në përgjegjësi administrimi të shoqërisë.
- 3.6 Njësia e Tregtimit të Energjisë Elektrike (NJTEE):** do të thotë njësia e parashikuar në strukturën organizative të shoqërisë si përgjegjëse, për zhvillimin e procedurës së tregtimit të energjisë elektrike dhe administrimit të kontratave të shitjes/blerjes së energjisë elektrike dhe/ose shërbimeve në tregun e energjisë elektrike.
- 3.7 Tregtim i energjisë elektrike:** do të thotë kalimi i ndërsjelltë, në formën e shitjes ose blerjes në sasi dhe në kohë të energjisë elektrike nga shitësi tek blerësi sipas pagesës dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kontratën përkatëse të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike dhe në legjislacionin në fuqi në RSH.
- 3.8 Procedurë tregtimi e energjisë elektrike:** do të thotë tërësia e veprimeve të kryera nga KESH për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike nga subjektet e licencuara.
- 3.9 Periudhë tregtimi e energjisë elektrike:** do të thotë kohështrirja në të cilën shitet/blihet energjia elektrike dhe që mund të jetë me profil orar/blloqe orare ose në profilin band, për periudha afatshkurtra ose afatgjata.
- 3.10 Periudhë afatshkurtër:** do të thotë shitja dhe/ose blerja e energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë (Intraday), në ditën në avancë (Day Ahead) ose për një periudhë jo më shumë 5 (pesë) ditë kalendarike pa ndërprerje.
- 3.11 Periudhë afatgjatë:** do të thotë shitja dhe/ose blerja e energjisë elektrike për një periudhë më shumë se 5 (pesë) ditë kalendarike pa ndërprerje.

- 3.12 Pjesëmarrës i regjistruar:** do të thotë një subjekt i licencuar që plotëson kushtet dhe kriteret për regjistrimin, i cili është kualifikuar dhe regjistruar nga KESH në regjistrin pjesëmarrësve në procedurat për shitjen/blerjen e energjisë elektrike.
- 3.13 Produkt tregtimi:** do të thotë energjia elektrike e propozuar për tregtim dhe e përcaktuar në kapacitet, sasi, periudhë lëvrimi, profil, etj.
- 3.14 Regjistri i pjesëmarrësve në procedurën e tregtimit të energjisë elektrike:** do të thotë një regjistër ku reflektohen të dhënat e parashikuara nga KESH për të gjithë pjesëmarrësit e kualifikuar për pjesëmarrje në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen nga KESH referuar parashikimeve në këtë rregullore.
- 3.15 Kërkesa/Ftesa për ofertë:** dokumenti zyrtar me ane të cilit Autoriteti Kontraktues iu drejtohet pjesëmarrësve të regjistruar dhe që publikohet detyrimisht në faqen elektronike të Autoritetit Kontraktues
- 3.16 Ofertë:** do të thotë tërësia e dokumenteve, të dërguar me postë elektronike (e-mail) me ane të se cilës një pjesëmarrës i regjistruar i përgjigjet kërkesës/ftesës për ofertë të dërguar si edhe të publikuar nga Autoriteti Kontraktues në faqen zyrtare të internetit.
- 3.17 Ofertues:** do të thotë pjesëmarrësi në procedurën e shitjes/blerjes së energjisë elektrike që paraqet një ofertë. .
- 3.18 Kushte të përgjithshme tregtare:** do të thotë tërësia e elementëve/kushteve në përmbajtje të formularit (përfshirë marrëveshjen/kontratë tip të shit-blerjes së energjisë elektrike) që nënshkruhet nga subjektet e licencuara gjatë procesit të regjistrimit në regjistrin e subjekteve të licencuar të kualifikuar për pjesëmarrje në procedurat që zhvillohen nga KESH për shitjen/blerjen e energjisë elektrike.
- 3.19 Kushte të veçanta tregtare:** do të thotë elementët/kushtet e veçantë (çmimi, kapaciteti, sasia, profili i shitjes/blerjes së energjisë elektrike, etj) në përmbajtje të njoftimit të fituesit dhe që konsiderohen pjesë e kontratës për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike të nënshkruar ndërmjet KESH dhe pjesëmarrësit të regjistruar..
- 3.20 Urdhrat për zhvillimin e procedurave të tregtimit të energjisë elektrike:** janë aktet e Titullarit të Autoritetit Kontraktues që përcaktojnë të dhëna të karakterit tekniko-ekonomik të procedurës së shitjes/blerjes si dhe komisionin që do të kryejë këto procedura.
- 3.21 Komisioni i zhvillimit të procedurës:** sipas rastit Komisioni i Blerjes ose Komisioni i shitjes që përbëhet nga 3 persona ose më shumë, në numër tek, të caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktues me detyrën e zhvillimit të procedurës së shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike në përputhje me parashikimet në këtë rregullore.
- 3.22 Kapacitetet e transmetimit/interkonjeksionit:** janë kapacitetet e interkonjeksionit të cilat sigurohen nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose Pjesëmarrësi i Regjistruar, për të mundësuar shitjen/blerjen e energjisë elektrike.
- 3.23 Kodet teknike të aplikueshme:** do të thotë të gjitha Kodet e Rrjetit, të miratuara nga Bordi i ERE
- 3.24 Listë e vlerësimit të partneritetit:** do të thotë një listë me të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar të renditur në rend zbritës nga partneri me vlerësimin më të lartë tek ai me vlerësimin më të ulët duke marrë për bazë nivelin e shkëmbimeve tregtare, respektimin e procedurave të tregtimit të energjisë elektrike dhe të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta tregtare, nga pjesëmarrësit e regjistruar në marrëdhënie me KESH.
- 3.25 Proces Optimizimi:** do të thotë shitje dhe blerje e energjisë elektrike gjatë vitit kalendarik ku në fund të vitit bilanci financiar dhe/ose energjetik rezulton pozitiv.

Neni 4

Parimet e Zhvillimit të Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike

- 4.1** Procedura e tregtimit të energjisë elektrike sipas kësaj rregullore do të realizohet në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës, transparencës dhe parimet e ruajtjes së konfidencialitetit.
- 4.2** Tregtimi i energjisë elektrike duhet të synojë realizimin me efikasitet të të ardhurave, optimizimin e portofolit të KESH duke pasur parasysh parimin tregtar bli lirë dhe shit shtrenjtë.

Neni 5

Regjistrimi i Pjesëmarrësve në Procedurën e Tregtimit të Energjisë Elektrike

- 5.1** Çdo subjekt i licencuar që dëshiron të regjistrohet në regjistrin e pjesëmarrësve në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike, së bashku me formularin e plotësuar sipas formatit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues si kusht për regjistrimin si pjesëmarrës në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues edhe dokumentacionin e nevojshëm administrativ që vërteton personalitetin juridik dhe zotësinë ligjore për pjesëmarrje në procedura të tregtimit të energjisë elektrike, nga institucionet kompetente të shteteve përkatëse ku janë regjistruar dhe ushtron aktivitetin apo ka selinë e tij qendrore si dhe nga institucionet e shtetit shqiptar si me poshtë vijon:
1. Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat perkates tregtar gjyqësor të shtetit në të cilin shoqëria është krijuar apo regjistruar.
 2. Licencën për tregtimin e energjisë elektrike të leshuar nga ERE për subjektet të cilët janë krijuar apo regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo shtetet perkatese për ata subjekte të licensuara të energjisë elektrike të cilët janë krijuar apo regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë.
 3. Dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës të cilët vërtetojnë se:
 - a. Tregtari nuk është në proces falimentimi;
 - b. Tregtari nuk është i dënuar për shkelje penale;
 - c. Nuk është i dënuar me vendim të gjykatës për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, fallsifikim etj.);
 - d. Ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve dhe taksave, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose atij të shtetit të origjinës;
 - e. Ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit shqiptar ose atij të shtetit të origjinës;
 - f. Nuk ka falimentuar dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbartimore.
 - g. Pasqyrat financiare të shoqërisë, të vitit të fundit, të certifikuara sipas rregullave të shtetit përkatës ku shoqëria ushtron aktivitetin.
- 5.2** Pas paraqitjes dhe vlerësimit si të rregullt të dokumentacionit të parashikuar në pikën 5.1, Autoriteti Kontraktues kualifikon subjektin e licensuar i cili ka kërkuar pjesëmarrjen dhe harton, mbanë dhe rishikon regjistrin e pjesëmarrësve. Në çdo kohë pjesëmarrësi i regjistruar mund të kërkojë Autoriteti Kontraktues pranimin e largimit dhe për pasojë heqjen e tij nga lista e pjesëmarrësve të regjistruar.
- 5.3** Dokumentacioni sipas pikës 5.1 do të përtërihet kryesisht, nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar, brenda muajit Dhjetor të çdo viti dhe do të jetë i vlefshëm për vitin pasardhës. Mos dërgimi i dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar passjell çregjistrimin e pjesëmarrësit të licensuar nga regjistrin e Autoritetit Kontraktues.
- 5.4** Subjekti i licencuar që shpreh për herë të parë interesin e tij apo rishtazi kërkon të regjistrohet si pjesëmarrës në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen nga Autoriteti Kontraktues, do të paraqesë pranë këtij të fundit dokumentacionin e parashikuar në pikën 5.1.
- 5.5** Pas përfshirjes në regjistrin e pjesëmarrësve, Autoriteti Kontraktues në të gjitha procedurat e zhvilluara nga ana e tij, i dërgon ftesë/ofertë pjesëmarrësve të regjistruar.
- 5.6** Në çdo rast dhe në çdo kohë Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë pjesëmarrësve të regjistruar, paraqitjen brenda një afati të arsyeshëm, të dokumentacionit të rifreskuar, me qëllim verifikimin e statusit ligjor të subjektit. Mos dërgimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar passjell çregjistrimin e pjesëmarrësit të licensuar nga regjistrin e Autoritetit Kontraktues

Neni 6

Lista e Vlerësimit të Partneritetit

- 6.1** Autoriteti Kontraktues bazuar në vlerësimin historik të 3 (tre) viteve të fundit të marrëdhënieve tregtare me pjesëmarrësit e regjistruar, do të hartojë një listë vlerësimi partneriteti me rend zbritës nga partneri i vlerësuar maksimalisht (10 pikë) tek partneri me vlerësimin më të ulët (4 pikë).
- 6.2** Vlerësimi i nivelit të partneritetit për efekt renditje në listën e parashikuar në pikën 6.1 do të bëhet duke marrë parasysh:

1. Kohëzgjatjen e partneritetit;
 2. Vëllimin tregtar (financiar);
 3. Respektimin e aspekteve procedurale sipas praktikave të mira të biznesit;
 4. Respektimin e kushteve kontraktuese.
- 6.3** Në cdo rast kur vlerësohet se një marrëdhënie tregtare e mundshme, me një pjesëmarrës të regjistruar me vlerësim të ulët, është në nivele më shumë se 30% e vëllimit tregtar (financiar) mesatar vjetor për 3 (tre) vitet e fundit, ose në të gjithë ato raste të pjesëmarrësve të regjistruar të cilët kanë vlerësim të ulët në listën e vlerësimit të partneritetit, Autoriteti Kontraktues mund të parashikojë kushte të veçanta të cilat janë në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë duke mos rënduar, në asnjë rast, pa të drejtë dhe në mënyrë diskriminuese pozitive e pjesëmarrësit të regjistruar.
- 6.4** Kur pjesëmarrësi i licencuar nuk respekton parime e një partneriteti të mirë dhe sjellja e tij është në kundërshtime me praktikën e mira të biznesit, me vendim të arsyetuar të Autoritetit Kontraktues i tërheq vëmendjen dhe i bëhet rivlerësim i pozicionit në listën e vlerësimit të partneritetit. Në rast përsëritje të sjelljeve jo të pranueshme, Autoriteti Kontraktues bazuar në praktikën e mira të biznesit me vendim të arsyetuar i njofton pezullimin nga regjistri i pjesëmarrësve dhe për pasojë i heq të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike nga KESH për një periudhë deri në 2 (dy) vite. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën e revokimit të vendimit të heqjes të së drejtës së pjesëmarrjes përpara afatit të vendosur, në rastet kur e gjykon të arsyeshme dhe vetëm me kërkesë të subjektit të interesuar.

Neni 7

Tregtimi i Energjisë Elektrike

- 7.1** NJTEE do të jetë përgjegjëse për të kryer në mënyrë të vazhdueshme analizën e tregut rajonal të energjisë elektrike dhe për të dalë në propozime mbi mundësinë për tregtimin e energjisë elektrike për qëllim optimizimi financiar.
- 7.2** Pas analizimit dhe vlerësimit të tregut rajonal të energjisë elektrike, NJTEE do të bëjë të njohur analizën dhe vlerësimin e saj NJAP-së duke kërkuar nga kjo e fundit konfirmim mbi mundësinë e rritjes apo të uljes së nivelit të gjenerimit të energjisë elektrike për produktin që propozohet për tregtim. Pas marrjes së konfirmimit NJTEE formon produktin e mundshëm për tregtim.
- 7.3** NJAP në vlerësim të situatës së gjenerimit të energjinë elektrike si pasojë e nevojës për respektimin e rregullores së shfrytëzimit racional dhe me efikasitet të njësive gjeneruese, informon NJTEE mbi nevojën e rritjes apo të uljes së nivelit të gjenerimit të energjisë elektrike. NJTEE duke marrë parasysh kërkesën e NJAP dhe pas vlerësimit të tregut rajonal të energjisë elektrike, në bashkëpunim me NJAP vendos për produktin e energjisë elektrike që garanton shfrytëzimin racional dhe me efikasitet të njësive gjeneruese.
- 7.4** NJTEE pas formimit të produktit sipas parashikimeve në pikë 7.2 dhe 7.3, i propozon Titullarit të Autoritetit Kontraktues dhënien e miratimit për tregtimin e produktit të propozuar.
- 7.5** Titullari i Autoritetit Kontraktues pasi merr në konsideratë vlerësimet e kryera nga NJTEE, urdhëron fillimin e procedurës së tregtimit të energjisë elektrike për produktin e propozuar nga NJTEE.

Neni 8

Vlerësimi i Ofertave

- 8.1** Në rastet e aplikimit të procedurave të shitjes së energjisë elektrike Autoriteti Kontraktues, në ftesën për shitje që i drejton pjesëmarrësve të regjistruar, përcakton kriterin e vlerësimit të ofertave, i cili në këtë rast do të jetë çmimi/njësi dhe/ose çmimet/njësi me të larta, të cilat rezultojnë të tilla në përfundim të procedurës së shitjes së energjisë elektrike.
- 8.2** Në rastet e aplikimit të procedurave të blerjes së energjisë elektrike Autoriteti Kontraktues, në ftesën për blerje që i drejton pjesëmarrësve të regjistruar, përcakton kriterin e vlerësimit të ofertave, i cili në këtë rast do të jetë çmimi/njësi dhe/ose çmimet/njësi më të ulta, të cilat rezultojnë të tilla në përfundim të procedurës së blerjes së energjisë elektrike.
- 8.3** Në rastin kur ofertat kanë të njëjtin çmim/njësi, duhet të aplikohet parimi "i pari që vjen, i pari shërbehet" (first come- first serve). Në rast se ofertat që kanë të njëjtin çmim/njësi vijnë në të njëjtën kohë, atëherë zbatohet parimi i ndarjes proporcionale.
- 8.4** Në të gjitha rastet e aplikimit të procedurave të shitjes dhe/ose të blerjes, Autoriteti Kontraktues nuk përllorarit çmim/njësi minimal fillestar.

Neni 9

Kërkesa/Ftesa për Ofertë

- 9.1** Për periudhat afatshkurtra dhe afatgjata të tregtimit, Titullari i Autoritetit Kontraktues, miraton kërkesën/ftesën për ofertë me termat përkatëse për tregtimin e produktit të tregtimit të propozuar nga NJTEE.
- 9.2** Kërkesa/ftesa për ofertë përmban të paktën elementet e mëposhtme:
1. Sasine e energjise elektrike në MWh që do të tregtohet;
 2. Grafikon e levrimit;
 3. Periudhen e levrimit në orë-bloqe orare/ditë/javë/muaj/vit;
 4. Siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;
 5. Piken e levrimit të energjise elektrike;
 6. Kriterin e vleresimit të ofertave;
 7. Afatin dhe mënyrën e dorezimit të ofertave
 8. Vlefshmërinë e ofertave;
 9. Kushtet e pagesave.
- 9.3** Në çdo rast, Autoritetit Kontraktues mund të parashikojë edhe kërkesa dhe/ose kushte të tjera, të cilat duhet të jenë të arsyeshme, jo-diskriminuese, në funksion të procedurës dhe në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Neni 10

Zhvillimi i Procedurës së Tregtimit

- 10.1** Pas përcaktimit të produktit për tregtim dhe hartimit të kërkesës/ftesës për ofertë sipas nenit 9, Titullari i Autoritetit Kontraktues, nxjerr urdhrin për zhvillimin e procedurës së tregtimit të energjise elektrike. Urdhri duhet të përmbajë të paktën:
1. Sasine e energjise elektrike në MWh që do të tregtohet;
 2. Grafikon e levrimit;
 3. Periudhen e levrimit në orë-bloqe orare/dite/javë/muaj/vit;
 4. Siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;
 5. Piken e levrimit të energjise elektrike;
 6. Kriterin e vleresimit të ofertave;
 7. Afatin dhe mënyrën e dorezimit të ofertave
 8. Vlefshmërinë e ofertave;
 9. Kushtet e pagesave.
- 10.2** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës i dërgon (nëpërmjet postës elektronike) kërkesën/ftesën për ofertë të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar.
- 10.3** Autoriteti Kontraktues do të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit çdo kërkesë/ftesë për tregtimin e energjise elektrike si dhe formatin e kontratës së shitjes/blerjes së energjise elektrike ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe pjesëmarrësit të regjistruar, në të njëjtën ditë që fton pjesëmarrësit e regjistruar për të marrë pjesë në procedurë. Kontrata e shitjes/blerjes së energjise elektrike hartohet dhe publikohet në gjuhën shqipe dhe angleze.
- 10.4** Brenda afatit të përcaktuar në kërkesë/ftesë për ofertë, Komisioni i Zhvillimit të Procedurës do të pranojë ofertat e dërguara nëpërmjet postës elektronike të pjesëmarrësve të regjistruar. Komisioni do të vlerësojë ofertat e paraqitura, do t'i krahasojë ato me kërkesat e përcaktuara në kërkesën/ftesën për ofertë që i është drejtuar të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar dhe do të shpallë fituese ofertën që plotëson kushtet e përcaktuara në kërkesën/ftesën për ofertë dhe kërkesat e nenit 8. Komisioni i Zhvillimit të Procedurës do të zbatojë të njëjtën procedurë edhe në kushtet e paraqitjes së vetëm një oferte.
- 10.4** Çdo ofertë e dërguar nga pjesëmarrësit e regjistruar e cila nuk është në përputhje me parashikimet dhe kërkesat e kërkesës/ftesës për ofertë të dërguar nga Autoriteti Kontraktues, do të konsiderohet e pavlefshme dhe nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni i Zhvillimit të Procedurës.
- 10.5** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës në përfundim të procedurës së vlerësimit do t'i paraqesë menjehere për miratim Titullarit të Autoritetit Kontraktues një raport përmbledhës të kryerjes së procedurës dhe propozimin për shpalljen fituese të pjesëmarrësve të regjistruar që kanë paraqitur çmimet/njesi me të favorshme, deri në plotësimin e sasise së kërkuar/ofruar për tregtim nga KESH.

- 10.6** Titullari i Autoritetit Kontraktues nga marrja e raportit përmbledhës, pas miratimit të tij, shpall oferten/ofertat fituese. Vendimi i njoftohet fituesve në formë elektronike.
- 10.7** Procedurat e zhvilluara për tregtimin e produkteve të energjisë elektrike në periudha afatshkurtra tregtimi zhvillohen brenda afateve kohore që gjykohen të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.
- 10.8** Procedurat e zhvilluara për tregtimin e produkteve të energjisë elektrike në periudha afatgjata tregtimi zhvillohen brenda një periudhe kohore jo më pak se 24 orë dhe jo më shumë se 72 orë nga momenti i dërgimit të kërkesës/ftesës për ofertë.
- 10.9** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës ka përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha ofertave të marra nga pjesëmarrësit e regjistruar.
- 10.10** Kontrata me pjesëmarrësin e regjistruar oferta e të cilit është shpallur fituese sipas formatit të publikuar paraprakisht në faqen e internetit të KESH konsiderohet e lidhur në momentin e njoftimit të fituesit. Nëse pjesëmarrësi i regjistruar, oferta e të cilit është vlerësuar nga komisioni fituese, por që ende nuk i është njoftuar, terhiqet nga pjesëmarrja, atëherë Autoriteti Kontraktues nëse e vlerëson të arsyeshme procedon me shpalljen fitues të ofertuesit të radhës.
- 10.11** I gjithë dokumentacioni së bashku me kontratën e lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar të shpallur fitues do të regjistrohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Anulimi i Procedurës së Tregtimit

Autoriteti Kontraktues në çdo rast mund të anulojë procedurën e tregtimit të energjisë elektrike për një nga arsyet e mëposhtme:

1. nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore të paraqitjes së tyre,
2. asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret dhe/ose kushtet tekniko-ekonomike, të përcaktuara në kërkesën/ftesën për ofertë,
3. të gjitha ofertat e pranuar përmbajnë çmime/njësi apo vlera që nuk justifikojnë qëllimin për të cilin është realizuar procedura;
4. për arsye të tjera të vërtetueshme, jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues dhe të paparashikueshme prej tij në kohën e njoftimit apo zhvillimit të procedurës së tregtimit të energjisë elektrike në emër të interesit të Korporatës dhe atij publik.

Neni 12

Sqarimi dhe Korrigjimi i Ofertave

- 12.1** Për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa me të drejte të ofertave të paraqitura nga ofertuesit, Komisioni i Zhvillimit të Procedurës, kur e gjykon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime ose informacion lidhur me to.
- 12.2** Autoriteti Kontraktues korrigjon ato gabime në oferte, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi nuk ndikon drejtpërsëdrejti në kushtet dhe kriteret thelbësore të ofertës.

Neni 13

Komisioni i Zhvillimit të Procedurës

- 13.1** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës përbëhet nga 3 ose më shumë anëtarë, në numër tek, dhe nga ku njëri nga anëtarët kryen funksionin e kryetarit.
- 13.2** Në përbërje të Komisionit të Zhvillimit të Procedurës duhet të ketë së paku 1 (një) anëtar me profesion jurist dhe 1 (një) anëtar me profesion ekonomist.
- 13.3** Titullari i NJTEE në çdo rast është kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Procedurës. Në mungesë të drejtuesit të NJTEE, vendin e kryetarit e zë punonjësi me eksperiencën më të gjatë në NJTEE, kjo procedurë ndiqet deri në plotësimin e vendit të kryetarit.
- 13.4** Përbërja e Komisionit të Zhvillimit të Procedurës caktohet nga Titullari i Autoritetit Kontraktues në urdhrin për zhvillimin e procedurës së tregtimit.

Neni 14

Deklarata e Konfliktit të Interesave

Çdo anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Procedurës do të nënshkruaj deklaratën me ane të se cilës shpreh mungesën e konfliktit të interesave të tij me pjesëmarrësit e regjistruar në KESH sh.a, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave. Nëse një nga anëtarët e Komisionit është në

kushtet e konfliktit të interesave me një nga pjesëmarrësit e regjistruar në KESH sh.a, atëherë Kryetari i Komisionit do t' i kërkojë Titullarit të Autoritetit Kontraktues zëvendësimin e tij.

Neni 15 Procedura e Ankimit

- 15.1** Cdo ofertues mund të kërkojë rishikim të vendimit për shpalljen fitues në procedurën e tregtimit të energjisë elektrike kur gjykon ose krijon bindje se vendimi i Titullarit të Autoritetit Kontraktues është i pabazuar dhe në kundërshtim me këtë rregullore.
- 15.2** Me përjashtim të procedurave të tregtimit të energjisë elektrike për periudhë afatshkurtër për të cilën nuk lejohen ankimi, në cdo procedurë tregtimi të energjisë elektrike ofertuesi i paraqet me shkrim (e-mail), Titullarit të Autoritetit Kontraktues jo me vonë se 24 ore nga momenti i njoftimit të rezultateve, ankesën perkatese. Në këto ankesa, ankimesi duhet të tregojë emrin & adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe pershkrimin e shkeljes së pretenduar. Me marrjen e ankesës si me sipër, Titullari i Autoritetit Kontraktues pezullon vazhdimin e procedurës së tregtimit në fjale, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht dhe ky shqyrtim të jetë shprehur në formën e një vendimi të shkruar nga Titullari i Autoritetit Kontraktues, i cili i dërgohet ankimesit (me e-mail), brenda 24 orësh nga marrja e ankesës.
- 15.3** Subjektit i rezervohet e drejta, bazuar në legjislacionin në fuqi, që pas procedurës së mësipërme, të drejtohet Gjykatës.
- 15.4** Mosparaqitja e ankesës në përputhje të plote me kushtet, termat dhe afatet e përcaktuara në këtë nen, e bën atë absolutisht të pavlefshme.

Neni 16 Monitorimi i Procedurave të Tregtimit të Energjisë Elektrike

- 16.1** Të gjitha procedurat e tregtimit të energjisë elektrike do të dokumentohen me saktësi. Asnjë procedurë tregtimi të energjisë elektrike nuk lejohet të kryhet pa dokumentacionin shoqëruar të kërkuar.
- 16.2** Deri më datë 15, të cdo muaji, Titullari i Autoritetit Kontraktues, paraqet në Këshillin Mbikëqyrës të kompanisë një raport analitik mbi procedurat e tregtimit të energjisë elektrike të zhvilluara në muajin paraardhës.
- 16.3** Autoriteti Kontraktues ka detyrimin t' i japë në mënyrë transparente cdo institucion të ngarkuar me ligj të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj, për tregtimin e energjisë elektrike.

Neni 17 Sanksione

Për shkeljen e ketyre rregullave, kur nuk përbën veprë penale ose kundërvajtje administrative, organet drejtuese të KESH zbatojnë parashikimet e akteve të tjera që rregullojnë aktivitetin e KESH.

Neni 18 Miratimi dhe Ndryshimi

- 18.1** Këto rregulla miratohen, ndryshohen dhe shfuqizohen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të KESH sh.a.
- 18.2** Për çështje të cilat nuk parashikohen në këtë rregullore por evidentohen gjatë zbatimit të saj, ngarkohet Administratori i shoqërisë që të veprojë kryesisht, në zbatim të parimeve të kësaj rregulloreje dhe parimeve bazë të legjislacionit civil dhe atij të procedurave administrative.
- 18.3** Nëse vlerësohet e nevojshme ndryshimi i një apo disa parashikimeve të kësaj rregulloreje, Administratori dërgon propozimet e tija së bashku me relacionet shpjeguese pranë Këshillit Mbikëqyrës i cili i shqyrton, miraton ato në parim, vendim të cilin Administratori i shoqërisë i'a përcjell Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, për miratim përfundimtar.

Neni 19 Dispozita kalimtare

- 19.1** Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të kësaj rregulloreje dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të shoqërisë, Administratori i shoqërisë duhet të miratojë formularët, kontratat tip dhe çdo dokument të nevojshëm për zbatimin e kësaj rregulloreje, si dhe të fillojë procedurën e regjistrimit të subjekteve të licensuara në regjistrin e pjesëmarrësve në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike.

19.2 Për periudhën deri në përfundim të afatit të mësipërm, shoqëria KESH sh.a. të vijojë zhvillimin e procedurave të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike sipas parashikimeve të rregulloreve të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike të miratuara nga ERE.

**Neni 20
Hyrja ne fuqi**

Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë.